



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

## MBI SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR BANORËT E BANESAVE SOCIALE

### Të nderuar Këshilltare !

Bashkia Berat ka planifikuar në buxhetin e saj për vitin 2025 fond për subvencionimin e qirasë për familjet me probleme sociale dhe ekonomike, që kanë në përbërjen familjare persona me aftësi të kufizuar, invalidë, që kanë të ardhura familjare mujore shumë të ulta kryesisht me pension dhe me përkrahje sociale, që plotësojnë kriteret e përcaktuara sipas nenit, 2 pika 34, 42, 45 dhe nenit 30 të ligjit nr.22/2018, ligjin nr.48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social ”.

Bashkia Berat që nga viti 2014, paguan çdo vit këstin e kredisë nga banka e Këshillit të Europës (CEB-i), ku bashkia ka detyrim të shlyeje principalin e kredisë, ndërsa Qeveria interesat e saj. Deri tani kemi shlyer vlerën e kredisë në shumën prej 585,107 € dhe na mbetet për të shlyer deri në vitin 2026 shuma prej 2,600 €.

Për fillimin e procedurës së subvencionimit të qirasë, bashkia ka njoftuar të gjitha familjet duke mos përjashtuar asnjë për të sjellë dokumentacionin e plotë të të ardhurave familjare mujore bazë, për llogaritjen e masës së subvencionimit të qirasë, mbështetur në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”.

Komisioni i Strehimit i mbledhur në datë 22.04.2025, ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar në bashki, nga banorët e strehuar në banesat sociale konkludoi si më poshtë:

Nga 49 familje të strehuara në apartamentet e banesave sociale, përfitojnë subvencionim të qirase 35 familje ndërsa 14 familje nuk e përfitojnë.

Kërkojmë nga ana Juaj miratimin e listës së familjeve të përbërë nga 35 familje që u kualifikuan nga Komisioni i Strehimit.

Bashkëlidhur lista e përfituesve dhe masa e subvencionimit e llogaritur për çdo familje .

DREJTOR I MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

Sokol Toska

Adresa:Blvd. “Republika ”, Berat 5001,Shqipëri,Tel /00355(0) 2 32 34 935,  
Website: [www.bashkiaberat.gov.al](http://www.bashkiaberat.gov.al), Email: [info@bashkiaberat.gov.al](mailto:info@bashkiaberat.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE , PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

## RELACION

### MBI MIRATIMIN E LISTËS NR.8 TË FAMILJEVE TË PASTREHA QË DO TË TRAJTOHEN ME KREDI ME INTERES 3%

Të nderuar Këshilltare !

Bashkia Berat në bashkepunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit vazhdon zbatimin e projektit "Banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti".

Ministria ka bërë përzgjedhjen e bankave që do të menaxhojnë këtë projekt nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredisë nga buxheti i shtetit dhe, konkretisht: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, dhe Banka Intesa Sanpaolo.

Programi i subvencionimit të interesave të kredisë trajton familje /individë që kanë aplikuar në portalin e -albania "Kërkesë për t'u trajtuar me programin e strehimit social banesë me kosto të ulët, Subvencionim i interesave të kredisë së zbutur".

Përparësi në përzgjedhje për t'u trajtuar me këtë projekt kanë familjet që plotësojnë kriteret e përcaktuar në ligjin 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar të cilat janë :

Kushtet e strehimit ku përparësi kanë familjet që:

- nuk disponojnë banesë në pronësi
- banojnë në banesa që paraqesin rrezik shëmbjeje
- banojnë në banesa të mbipopulluara

Kushtet familjare ku përparësi kanë familjet që:

- familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë
- të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit
- familjet me më shumë se katër fëmijë
- çiftet e reja

Kushtet sociale ku përparësi kanë familjet që:

- personat me aftësi të kufizuar
- vajzat nëna
- anëtar të komunitetit rom e egjiptian
- individë me status të jetimit etj

Kushtet ekonomike janë në përputhje me madhësinë e përbërjes familjare të përcaktuara nga INSTAT .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Berat për ta bërë procesin sa më transparentë në mënyrë që të mos penalizohet asnjë familje e interesuar dhe që plotëson kushtet e nivelit të të ardhurave mujore në fillim të procesit ka bërë njoftim në faqen zyrtare të bashkisë [ëëë.bashkiaberat.gov.al](http://ëëë.bashkiaberat.gov.al) më datë 04.02.2025 "*Mbi fillimin e projektit të subvencionimit të interesave të kredisë*", ku janë publikuar dokumentacioni përkatës dhe kriteret që duhet të plotësojë çdo person i interesuar i cili ka aplikuar si i pastrehë në portalin e-albania.

Komisioni i Strehimit i mbledhur më datë 22.04.2025, ka miratuar subvencionimin e kredisë për 21 familje të pastreha që do të trajtohen me kredi me interes 3%, të cilat plotësojnë kriteret ligjore dhe dokumentacionin përkatës, sipas tabelës bashkëlidhur.

Ndërsa 15 familje u s'kualifikuan për mungesë dokumentacioni dhe për mos plotësim të kriterëve kualifikuese .

**DREJTOR I MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE**

**Sokol Toska**

LISTA NR.8 E FAMILJEVE QE DO TE TRAJTOHEN ME KREDI ME INTERES 3%

| Nr.<br>Rend<br>or | Emri/Atësia/Mbiemri       | Perberja<br>familjare<br>sipas<br>certifikat<br>es fam<br>gjendja<br>aktuale | Struktura e<br>apartamentit qe<br>perfiton | Kushtet e strehimit<br>sipas (shkronja "a"<br>neni 16) | Kushtet familjare<br>sipas (shkronja "<br>b" neni 16) | Kushtet sociale sipas<br>(shkronja "c" neni 16) | Te ardhurat<br>mujore neto<br>te familjes | Punesimi              | Vlera max e<br>perfitimit te<br>kredise |
|-------------------|---------------------------|------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|--------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|-------------------------------------------------|-------------------------------------------|-----------------------|-----------------------------------------|
| 1                 | 2                         | 3                                                                            | 4                                          | 5                                                      | 6                                                     | 7                                               | 8                                         | 9                     | 10                                      |
| 1                 | Elsona Pellumb Jorgji     | 2                                                                            | 1+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    | K/fam e vetme<br>me femije                            |                                                 | 51,520                                    | Punesuar ne<br>shtet  | 2,871,000                               |
| 2                 | Vjollca Andrea Tavanxhi   | 3                                                                            | 2+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    | K/fam e vetme<br>me femije                            |                                                 | 76,360                                    | Punesuar ne<br>privat | 4,228,200                               |
| 3                 | Edmond Ramadan Pashaj     | 4                                                                            | 2+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    |                                                       | Familje ne perberjen<br>familjare invalide      | 80,640                                    | Punesuar privat       | 4,228,200                               |
| 4                 | Loredja Qemal Shehu       | 2                                                                            | 1+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    | K/fam e vetme<br>me femije                            |                                                 | 69,164                                    | Punesuar ne<br>shtet  | 2,871,000                               |
| 5                 | Almida Robert Bumblji     | 2                                                                            | 1+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    | K/fam e vetme<br>me femije                            |                                                 | 78,830                                    | Punesuar ne<br>shtet  | 2,871,000                               |
| 6                 | Elena Vladimir Selimllari | 3                                                                            | 2+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    | K/fam e vetme<br>me femije                            |                                                 | 76,516                                    | Punesuar ne<br>shtet  | 4,228,200                               |
| 7                 | Marinela Skender Pashaj   | 2                                                                            | 1+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    | Familje e re                                          |                                                 | 70,268                                    | Punesuar ne<br>shtet  | 2,871,000                               |
| 8                 | Llambirini Aurel Bitri    | 3                                                                            | 2+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    | Familje e re                                          |                                                 | 93,694                                    | Punesuar ne<br>shtet  | 4,228,200                               |
| 9                 | Zhaneta Shyqeri Puce      | 5                                                                            | 3+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    |                                                       | Familje e komunitetit<br>egjiptian              | 114,539                                   | Punesuar ne<br>privat | 5,220,000                               |
| 10                | Karafil Azis Guce         | 2                                                                            | 1+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    | Familje e re                                          |                                                 | 73,777                                    | Punesuar ne<br>shtet  | 2,871,000                               |
| 11                | Kristaq Artur Gode        | 2                                                                            | 1+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    | Familje e re                                          |                                                 | 79,520                                    | Punesuar ne<br>privat | 2,871,000                               |
| 12                | Sara Eduart Gorica        | 4                                                                            | 2+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    | Familje e re                                          |                                                 | 95,297                                    | Punesuar ne<br>shtet  | 4,228,200                               |
| 13                | Klodian Hekuran Cilingiri | 4                                                                            | 2+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    |                                                       | Familje e komunitetit<br>egjiptian              | 80,000                                    | Punesuar ne<br>privat | 4,228,200                               |
| 14                | Erjon Gezim Harizaj       | 4                                                                            | 2+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    | Familje e re                                          |                                                 | 90,000                                    | Punesuar ne<br>privat | 4,228,200                               |
| 15                | Menduar Maliq Cufe        | 3                                                                            | 2+1                                        | Nen/normalt e<br>strehimit                             |                                                       |                                                 | 81,393                                    | Punesuar ne<br>privat | 4,228,200                               |
| 16                | Erjola Fuat Llangozi      | 4                                                                            | 2+1                                        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi                    |                                                       |                                                 | 105,440                                   | Punesuar ne<br>privat | 4,228,200                               |

|    |                        |   |            |                                     |              |                                    |         |                       |           |
|----|------------------------|---|------------|-------------------------------------|--------------|------------------------------------|---------|-----------------------|-----------|
| 17 | Manjola Daut Kembaci   | 5 | 2+1        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi |              | Familje e komunitetit<br>egjiptian | 119,347 | E vetpunësuar         | 4,228,200 |
| 18 | Egland Luka Lamaj      | 2 | 1+1        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi | Familje e re |                                    | 82,530  | Punësuar në<br>shtet  | 2,871,000 |
| 19 | Entela Kadri Baku      | 4 | 2+1        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi |              |                                    | 106,093 | Punësuar në<br>shtet  | 4,228,200 |
| 20 | Fredi Lahim Rusi       | 3 | 2+1        | Nuk disponojne<br>banese në pronësi |              |                                    | 90,000  | Punësuar në<br>privat | 4,228,200 |
| 21 | Bersan Dhimiter Prendi | 1 | garsoniere | Nuk disponojne<br>banese në pronësi |              |                                    | 44,400  | Punësuar në<br>privat | 2,349,000 |



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQESISE ADMINISTRIMIT TE PYJEVE, UJERAVE DHE**  
**SHERBIMIT VETERINAR**

Berat , më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2025

**RELACION**

**PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË PLANIT TË MASAVE PARANDALUESE TE**  
**ZJARREVE VITI 2025**

Në zbatim ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjit nr. 107/2014 datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Bazuar në ligjin nr 152, datë 21.12. 2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”.

**1. Dokumentacioni dhe procedura e ndjekur.**

Specialistët e pyjeve pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimi i Pyjeve , Ujërave dhe shërbimi veterinar- bashkia berat kanë hartuar planin e parandalimit dhe menaxhimit të zjarreve për vitin 2025.

Është ndërtuar skema e lajmërimit në rast zjarri

**Bashkëlidhur me këtë relacion do të gjeni:**

- 1. Kopje të planit të masave per parandalimin e zjarreve për vitin 2025.**
- 2. Për diskutim: Miratimin paraparak të planit të masave parandaluese të zjarreve për vitin 2025.**

**Pas diskutimit nga anëtarët prezentë propozojmë të meren vendimet:**

**1.Të miratojë planin e masave parandaluese të zjarreve për vitin 2025.**

**2.Për zbatimin e këtij Vendimi dhe vazhdimin e procedurave të ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave.**

Drejtori

Bledar Çili






BASHKIA BERAT

DREJTORIA E BUQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE SHËRBIMIT VETERINAR BERAT

VITI 2025

### SKEMA E LAJMERIMIT NE RAST RENIE ZJARRI



Shënim: Administratorët e N.J.A për çdo rast të marrin kontakt me kryetarët e fshatrave.

Ing. Jurgen Abedini

*[Signature]*

DREJTOR  
Bledar Çili





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJERAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**

**PLANI PARANDALIMIT DHE MENAXHIMIT TË ZJARREVE**  
**PËR VITIN 2025**

Gjatë periudhës së verës si rezultat i temperaturave të larta ,thatësirës që karakterizon zonën e fondit pyjor dhe kullësor të Bashkisë Berat,është e nevojshme një menaxhim dhe administrim sa më i mirë nga ana e Bashkisë me të gjitha mundësitë njerëzore , financiare dhe materjale që ka në dispozicion për parandalimin e zjarreve.

Përmes bashkëpunimit dhe me institucionet e tjera si MZSH –Berat, Prefektura, Policia e Rendit dhe IKMT mund të menaxhohen dhe parandalohen situatat e vështira që mund të krijohen nga zjarret. Me qëllim rritjen e sigurisë publike ,ruajtjen e pronës dhe mjedisit në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Vendimi nr.1080, datë 22.12.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve”; dhe ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin, mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri vëmendja përqendrohet në parandalimin e emergjencave dhe minimizimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarret në masivet pyjore,parqe,kullota ,plantacione pemtarie etj. Nisur nga përvoja e viteve të mëparshme zonat me rrezikshmëri më të lartë janë :

- **Mali Partizan – Mali Veterrikut** , kjo zonë është pyllëzuar me pishë mesdhetare në vitet 60-70 dhe është një zonë e thatë pa ujra sipërfaqësor dhe burime të tjera ujore.Zakonisht zjarret në këtë zonë shfaqen gjatë muajve korrik-shtator.Karakterizohet nga një rrjet jo të përshtatshëm rrugor ku mundësitë për ndërhyrje me automjete janë tepër të pakta.Shkaqet kryesore të shfaqjes së zjarreve vijnë nga barinjët e zonës dhe shkaqe pakujdesie.Për këtë zonë parashikojmë të kryejmë patrullime nga Ura e Goricës deri te Proji Turbullt si dhe në aksin rrugor Starovë-Veterrik-Gur Bardhë.

- **Zona Velçan – Plashnik-Osmëzezë** ku shkaktarët kryesorë të zjarrvënies janë barinjët e zonës me qëllim hapjen rrugëve dhe celtirave për kullotjen e bagëtive. Zakonisht zjarret në këtë zonë shfaqen gjatë muajve korrik-shtator.

**Zona Qereshnik**, një zonë e veshur me bimësi pyjore ku mbizotëron marja, ilqja, pisha mesdhetare por që nuk ka një rrjet të përshtatshëm rrugor. Pjesa midis fshatrave Qereshnik-Pëllumbas ka probabilitetin më të lartë të shfaqjes së fenomenit të zjarreve.

- **Zona Malinat**, e veshur kryesisht me shkurre të llojit mare. Zonë e populluar që përshkohet nga rrugë të shumta pyjore dhe rurale. Karakterizohet nga mungesa e burimeve ujore dhe thatësira që zgjat gjatë muajve korrik-shtator.
- **Zona Roshnik** e cila ndahet në 2 nënzona, në nënzonën e mares dhe rrobullit. Paraqesin rrezikshmeri të lartë në shfaqjen e fenomenit të zjarrvënies për efekt të terrenit mjaft të pjerrët ku mundësitë për ndërhyrje janë mjaft të ulta. Periudha e shfaqjes së zjarreve është kryesisht gjatë muajve gusht-tetor.

## ZONAT E RRISKUT

Në bazë të monitorimit të fondit pyjor në tërësi një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe evidentimit të rreziqeve të mundshme që mund të jenë evidente për shkaktimin e zjarreve në sipërfaqet pyjore dhe konkretisht problem primar i cili ka nevojë për ndërhyrje të menjëherëshme, kjo në bashkëpunim edhe me OSHE Berat, paraqitet në 2 (dy) zona Pyjore si më poshtë:

1. Në ekonominë pyjore Mali i Bardhë në fshatin Velçan linja e tensionit që lidh atë me fshatin Levan është shumë e ulët dhe në disa segmente në brëndësi të pyllit, cka është rrezik evident për shkaktim të zjarrit.

Për ti paraprir gjith situatave do bëhet ndërhyrje të menjëherëshme për prerjen e shkurreve dhe pastrimin e kësaj linje, kjo në bashkëpunim me OSHE.

2. Në Ekonominë pyjore Hija e Roshnikut në fshatin Korce linja e tensionit që lidh atë me fshatin Kostren është në disa segmente në brëndësi të pyllit, cka është rrezik evident për shkaktim të zjarrit.

Për ti paraprir gjith situatave do bëhet ndërhyrje të menjëherëshme për prerjen e shkurreve dhe pastrimin e kësaj linje, kjo në bashkëpunim me OSHE.

3. Në Ekonominë Pyjore Mali i Molishtit parashikohet pastrimi I një rruge egzistuese që lidh fshatin Molisht me fshatin Plashnik 2, rrugë e cila do shërbejë edhe si rrugë Auto-pyjore për mbrojtjen se sipërfaqeve pyjore/kullosore nga zjarri.

## • MASAT PËR PARANDALIMIN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA

Përcaktimi i sistemit të vrojtim-sinjalizimit ku në zonat më problematike do të caktohen 3 -6 vëzhgues nga drejtoria në zonat Mali Molisht, Kalaja, Mali Partizanit, Ekonomia Pujore Hija e Roshnikut, Mali Bardhë, Ekonomia Pyjore Bregu Balibardhes.

Sinjalizimi në kohë sa më të shpejtë ka rëndësi të madhe në zbutjen e pasojave që mund të shfaqen nga zjarret. Izolimi dhe fikja në momentet e para bën që pasojat dhe dëmet e shkaktuara të jenë sa më të vogla. Për këtë qëllim sistemi i vrojtim-sinjalizimit ka një rëndësi tepër të madhe dhe kjo arrihet vetëm nëpërmjet bashkëpunimit dhe shpërndarjes së nr. të telefonit me të gjithë personelin e ngarkuar në këtë detyrë. Çdo person që konstaton raste zjarri duhet urgjentisht të lajmërojë në një kohë sa më të shpejtë me të gjitha mjetet e mundshme që ka në dispozicion.

**Në cdo fshat është përgatiten listat e skuadrave vullnetare ku përgjegjës për to do të jenë kryetarët e fshatrave sipas njësive administrative, Velabisht, Otlak, Roshnik dhe Sinjë.**

Me marrjen e njoftimit drejtoria B.AP.U&SHV , Bashkia Berat do të kërkojë ndihmën e institucioneve të tjera në rastet kur përmasat e zjarrit do të jenë të mëdhaja. Nqs zjarri ka përmasa të vogla situatat mund të menaxhohen dhe me personelin e drejtorisë ose banorët që mund të ndodhen në vënd. Për cdo rast do të raportohet dhe në IKMT dhe Prefekturë.

## • NGRITJA DHE INSTRUKTIMI SKUADRAVE TË MZSH NË FSHATRA

Në fshatrat që kanë në afërsi të tyre pyje dhe kullotave do të mbahen kontakte me kryetarët e fshatrave për ngritjen e skuadrave vullnetare. Vazhdimisht do të bëhet rishikimi tyre ne rast se do të ketë ndonjë largim të mundshëm. Këto skuadra do të jenë të parat që do të marrin pjesë në konstatimin, fikjen dhe izolimin e zjarrit. Aktualisht po punohet ende në ngritjen e këtyre skuadrave ku janë shpërndarë formularët në njësitë administrative.

## TABELAT QE SENSIBILIZOJN RREZIKUN E ZJARREVE NE PYJE E KULLOTA

Per kete qellim jane shperndar mbishkrime kusensibilizohet komuniteti per rrezikun e zjarreve, mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri si dhe sanksionet ligjore ndaj kundravajtjeve. Takimet sensibilizuese jane zhvilluar ne perjudhen prill-maj ne te gjitha njesit administrative (Sinje, Roshnik, Velabisht, Otlak).

## IDENTIFIKIMI MJETEVE , PAJISJEVE DHE BURIMEVE NJERËZORE

Mundësia e lëvizjes së personelit dhe punonjësve të drejtorisë do të bëhet me mjetin tip Furgon Wolfswagen me targë AA 308 EF. Benz ML 27 me targë AA 007 MI dhe me mjetin mercedes benz ( kamjonecine) me targ AA 437 OB dhe me mjete të tjera private. Për sa i përket burimeve njerëzore në fikjen dhe izolimin e zjarrit do të marrin pjesë stafi bashkisë, skuadrat e MZSH, si dhe banorët e rastësishëm në vendodhje.

## PËRCAKTIMI ITINERARIT NË RASTE ZJARRI

Konkretisht kemi menduar që për zjarret në zonën Velçan-Osmëzezë-Plashnik do të përdoret rruga auto Berat-Plashnik 2, në njësinë administrative Velabisht do të përdoret rruga auto Berat-Veterrik, Berat-Mbreshtan, Berat-Gjeroven, Berat-Drobonike, në njësinë administrative Roshnik do të përdoret rruga auto Berat – Dardhë, Berat- karkanjozë, Berat Roshnik, etj.

D.B.AP.U&SH V  
D R E J T O R I  
Bledar Çili





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK**

**RELACION**

**MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR**  
**AFATMESEM 2026-2028**

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të Kalendarit Buxhetor të miratuar nga Këshilli Bashkiak në muajin Dhjetor 2024, po ju paraqesim për miratim tavanet përgatitore të PBA 2026-2028.

Në përputhje me nenet 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe Udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka nxjerrë udhëzim nr. 8 datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e PBA vendor 2026-2028”, i cili përmban:

- a) Shtojca 1 : Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për rritjen e pagave për bashkitë dhe qarqet për periudhën 2026-2028;
- b) Shtojca 2 : Struktura e Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028
- c) Shtojca 3 : Treguesit kryesorë të kuadrit makroekonomik e fiskalë 2026-2028
- d) Shtojca 4 : Lista orientuese e Produkteve Standarde sipas 20 programeve buxhetore të NJVQV-ve
- e) Shtojca 5 : Metodologjia e re e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit 2026 për Bashkitë: Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak, Belsh, Fier, Patos, Fushë Arrëz, Skrapar, Mat, Delvinë, dhe Qarqet: Shkodër, Gjirokastrë, Korçë
- f) Shtojca 6 : Manual i përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV)
- g) Shtojca 7 : Detyrat e Sugjeruara dhe Afatet e Brendshme për Miratimin e Projekt Dokumentit të PBA-së Faza e parë (Projektdokumenti i PBA-së)
- h) Shtojca 8 : Detyrat e Sugjeruara dhe Afatet e Brendshme për Miratimin e Dokumentit të Rishikuar të PBA Faza e dytë (Dokumenti i Rishikuar i PBA- së)

Në Udhëzimin “Për përgatitjen e PBA vendor 2026-2028”, cilësohet se Bashkia Berat, së bashku me bashkitë Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak, Belsh, Fier, Patos, Fushë Arrëz, Skrapar, Mat, dhe Delvinë do të përgatisin Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 bazuar në metodologjinë e re sipas shtojcës 5, bashkëlidhur udhëzimit.

Metodologjia e re mbështetet në katër kritere të rëndësishme:

- a) Struktura e programeve buxhetore të NJVQV-ve pilot bazohet në strukturat kryesore të ofrimit të shërbimeve të NJVQV-ve (por nuk njehsohet domosdoshmërisht me to).
- b) Ruajtja e raportimit funksional të shpenzimeve për 36 klasa të nivelit të 3-të të COFOG.
- c) Heqja e detyrimit të NJVQV-ve për të patur deri në 20 programe (të bazuara në nivelin 3 COFOG), 20 Ekipa të Menaxhimit të Programit dhe 20 DEMP.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK**

d) Ruajtja e një numri të menaxhueshëm të programeve buxhetore, duke shmangur problematikën e numrit shumë të madh të programeve të vogla që aktualisht përdorin njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Parimet themelore të metodologjisë së re, që do të zbatohet nga këto NJVQV janë:

- a) Shkëputja e dimensionit të funksionit nga ai i programit për raportimin funksional të shpenzimeve. Funksioni do të identifikohet tashmë përmes kodit të produktit (dhe jo kodit të programit) për raportimin fiskal.
- b) Lejimi i NJVQV-ve që të krijojnë programe buxhetore të ngjashme me strukturat e menaxhimit të shërbimeve:
  - Kodet për programet e reja të jenë të ndryshme dhe të dallueshme nga kodet e programeve të vjetra të NJVQV-ve (shiko më poshtë Seksionin e fundit të kësaj shtojce).
  - Kodet e reja në planin e llogarive për programet e reja do të përfshihen në përgatitjen e buxhetit të NJVQV-ve dhe në sistemin e thesarit për qëllime të përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit.
- c) Kodet e produkteve do të mundësojnë raportim të saktë fiskal kundrejt nivelit të 3-të të COFOG (36 funksioneve të qeverisjes vendore).
- d) Dimensioni i funksionit do të përdoret vetëm për raportim dhe raportimi funksional i shpenzimeve do të kryhet përmes kodit të produktit, përcaktuar si më poshtë në shtojcë.
- e) Përgatitja dhe Zbatimi i Buxhetit Vjetor do të bëhet në nivel produkti, krahas klasifikimeve të tjera buxhetore të përcaktuara me ligj.

**I. Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm**

- Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028, në nivel programi buxhetor.
- Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2026-2028 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 83 datë 05.02.2025, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028. Kuadri makroekonomik e fiskal pasqyron parashikime të treguesve ekonomikë dhe financiarë të buxhetit të qeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme. Nëpërmjet vlerësimeve të paraqitura në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal, njësia e vetëqeverisjes vendore do të analizojë burimet që do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
- Këto vlerësime përbëjnë bazën për të përcaktuar Tavanet e Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Një “tavan” në këtë kontekst është kufiri i sipërm i shumës totale të parave që mund të shpenzohen ose të planifikohen për t’u shpenzuar për një qëllim të caktuar.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore në hartimin e projektbuxhetit për periudhën 2026-2028 dhe për përcaktimin e nivelit të pagave duhet të bazohen në kuadrin ligjor në fuqi.
- Transferta e pakushtëzuar të përgjithshme dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitet 2026-2028, së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore, financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në qeverisjen vendore deri në vitin 2025.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK**

Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

**Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme**

Madhësia e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe transfertës sektoriale për rritjen e pagave për periudhën 2026-2028, paraqitet sipas shtojcës 1 të Udhëzimit për hartimin e PBA-së 2026-2028.

Kriteret dhe koeficientët e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2026-2028 janë sipas përcaktimeve në nenin 24, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Në përlllogaritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2026, kriteret e përdorura dhe ato që do të përdoren për PBA-në 2026-2028 janë: popullsia (harmonizim midis të dhënave të regjistrit të gjendjes civile dhe censusit), dendësia e popullsisë për km<sup>2</sup>, numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki.

Për Bashkinë Berat është parashikuar kjo ndarje e transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme :

- Për vitin 2026 , shuma 517,760 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2025 transferta është parashikuar me rritje + 41,001 mijë lekë, ose +8.6%.

- Për vitin 2027 , shuma 556,680 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2026 transferta është parashikuar me rritje + 38,920 mijë lekë, ose +7.5%.

- Për vitin 2028 , shuma 584,804 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2027 transferta është parashikuar me rritje + 28,124 mijë lekë, ose +5%.

**Për secilin vit është parashikuar Transferta e pakushtëzuar sektoriale për rritjen e nivelit të pagave në shumën 68,465 mijë lekë.**

**Transferta e pakushtëzuar sektoriale**

- Transferta e pakushtëzuar sektoriale parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2026-2028, për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara tek bashkitë në vitin 2016. Sipas akteve ligjore në fuqi funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, shpenzimeve për investime do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Bashkitë mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.

- Ndarja e Transfertës së pakushtëzuar sektoriale sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2026-2028, do të jetë në të njëjtat nivele me ndarjen e transfertës së miratuar me buxhetin e vitit 2025.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK**

Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për bashkinë Berat për periudhën 2026-2028

vlerat paraqiten në: 000 ALL

| TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE |                                              | 2026        | 2027        | 2028        |
|--------------------------------------|----------------------------------------------|-------------|-------------|-------------|
|                                      |                                              | Plani       | Plani       | Plani       |
|                                      |                                              | 362,071.054 | 362,071.054 | 362,071.054 |
| 1                                    | Konviktet e arsimit parauniversitar          | 30,230.514  | 30,230.514  | 30,230.514  |
| 2                                    | Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor | 160,068.999 | 160,068.999 | 160,068.999 |
| 3                                    | Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës  | 50,968.345  | 50,968.345  | 50,968.345  |
| 4                                    | Arsimi parauniversitar                       | 17,476.556  | 17,476.556  | 17,476.556  |
| 5                                    | Mbrojtja nga zjarri                          | 46,480.711  | 46,480.711  | 46,480.711  |
| 6                                    | Mbrojtja sociale                             | 26,207.850  | 26,207.850  | 26,207.850  |
| 7                                    | Administrimi i pyjeve                        | 6,999.775   | 6,999.775   | 6,999.775   |
| 8                                    | Rrugët                                       | 6,174.982   | 6,174.982   | 6,174.982   |
| 9                                    | Ujitja dhe Kullimi                           | 17,463.322  | 17,463.322  | 17,463.322  |

#### Transferta e kushtëzuar

- Transferta e kushtëzuar parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2026-2028, për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Shuma e transfertave të kushtëzuara do të jetë rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës.

#### Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

- Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, si burim financimi i funksioneve të bashkisë, për periudhën 2026-2028 parashikohen të jenë :  
për vitin 2026 parashikohen të jenë 646,481 mijë lekë, me rritje + 8,507 mijë lekë në krahasim me vitin 2025 ose +1.3% ;  
për vitin 2027 parashikohen të jenë 651,975 mijë lekë, me rritje + 5,494 mijë lekë në krahasim me vitin 2026 ose +0.8% ;  
për vitin 2028 parashikohen të jenë 656,747 mijë lekë, rritje + 4,772 mijë lekë në krahasim me vitin 2026 ose +0.7%.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK**

Të ardhurat Vendore ( taksa&tarifa vendore)

në mijë lekë

| Nr                                      | Emertimi/Muaji                                              | Plani 2025     | Plani 2026     | Plani 2027     | Plani 2028     |
|-----------------------------------------|-------------------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| <b>I</b>                                | <b>Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel</b> |                |                |                |                |
| <b>II</b>                               | <b>Taksa mbi te ardhurat personale</b>                      | <b>20,294</b>  | <b>20,903</b>  | <b>21,530</b>  | <b>22,176</b>  |
| <b>III</b>                              | <b>Taksat vendore</b>                                       | <b>225,146</b> | <b>231,344</b> | <b>237,727</b> | <b>244,303</b> |
| 1                                       | Takse tabele                                                | 2,674          | 2,754          | 2,837          | 2,922          |
| •                                       | Tabelë për qëllime identifikimi                             | 2,053          | 2,114          | 2,178          | 2,243          |
| •                                       | Tabelë për qëllime reklamimi                                | 621            | 640            | 659            | 679            |
| 2                                       | Te ardhura nga zenia e hapsirave publike                    | 17,264         | 17,782         | 18,316         | 18,865         |
| 3                                       | Takse ndikimi ne infrastrukture nga ndertimet e reja        | 81,885         | 84,342         | 86,872         | 89,478         |
| 4                                       | Takse fjetje ne hotel                                       | 7,046          | 7,258          | 7,475          | 7,700          |
| 5                                       | Takse mbi token bujqesore                                   | 18,555         | 18,555         | 18,555         | 18,555         |
| 6                                       | Takse e mjeteve te perdorura                                | 32,017         | 32,977         | 33,967         | 34,986         |
| 7                                       | Takse e kalimit te se drejtes se pronesise pronësisë        | 3,278          | 3,377          | 3,478          | 3,582          |
| 8                                       | Takse mbi ndertesat                                         | 54,425         | 56,058         | 57,740         | 59,472         |
| 9                                       | Takse Trualli                                               | 8,000          | 8,240          | 8,488          | 8,742          |
| 10                                      | Te tjera taksa lokale                                       | -              | -              | -              | -              |
| <b>IV</b>                               | <b>Tarifat vendore</b>                                      | <b>224,491</b> | <b>224,817</b> | <b>225,151</b> | <b>225,496</b> |
| 1                                       | Tarife e pastrimit                                          | 104,777        | 104,777        | 104,777        | 104,777        |
| 2                                       | Tarife e ndriçimit publik                                   | 47,683         | 47,683         | 47,683         | 47,683         |
| 3                                       | Tarife gjelberimi publik                                    | 40,250         | 40,250         | 40,250         | 40,250         |
| 4                                       | Tarife Arsimit                                              | 11,135         | 11,135         | 11,135         | 11,135         |
| 5                                       | Tarife regjistrim veprimtarie biznesi                       | -              | -              | -              | -              |
| 6                                       | Tarifa urbanistike                                          | 711            | 732            | 754            | 777            |
| 7                                       | Tarifa te sherbimit administrativ                           | -              | -              | -              | -              |
| 8                                       | Tarife per license/certifikate ne fushen e transportit      | 2,287          | 2,355          | 2,426          | 2,499          |
| 9                                       | Tarfia per zenie salle dhe dheniie ambjentesh me qera       | 25             | 25             | 26             | 27             |
| 10                                      | Tarifa te sherbimit te varrimit                             | 9,808          | 9,808          | 9,808          | 9,808          |
| 11                                      | Tarife per lende drusore                                    | 2,484          | 2,558          | 2,635          | 2,714          |
| 12                                      | Tarife Ujitje                                               | 3,245          | 3,342          | 3,442          | 3,545          |
| 13                                      | Tarife ambienti                                             | 1,052          | 1,083          | 1,116          | 1,149          |
| 14                                      | Tarife therje                                               | -              | -              | -              | -              |
| 15                                      | Te tjera tarifa                                             | -              | -              | -              | -              |
| 16                                      | Taksa e rentës minerare                                     | 183            | 189            | 195            | 200            |
| 17                                      | Tarife Urbanistike (kablloret)                              | 852            | 878            | 904            | 931            |
| <b>V</b>                                | <b>Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit</b>            | <b>21,524</b>  | <b>22,170</b>  | <b>22,835</b>  | <b>23,520</b>  |
| 1                                       | Te ardhurat per regjistrim                                  | 896            | 923            | 951            | 979            |
| 2                                       | Te ardhura nga konviktet                                    | 3,013          | 3,103          | 3,196          | 3,292          |
| 3                                       | Te ardhura nga kopshtet dhe cerdhet                         | 17,615         | 18,143         | 18,688         | 19,248         |
| <b>VI</b>                               | <b>Te ardhura te tjera</b>                                  | <b>146,519</b> | <b>147,248</b> | <b>144,730</b> | <b>141,252</b> |
| 1                                       | Te ardhura nga parkimi                                      | 3,205          | 3,301          | 3,400          | 3,502          |
| 2                                       | Te ardhura nga qerate                                       | 32,522         | 33,498         | 34,502         | 35,538         |
| 3                                       | Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..                      | -              | -              | -              | -              |
| 4                                       | Te tjera te ardhura nga pronesia                            | 62,996         | 62,996         | 62,996         | 62,996         |
| 5                                       | Te tjera debitore dhe gjyqe                                 | 6,901          | 7,108          | 7,321          | 7,541          |
| 6                                       | Debitore Biznes + Familje                                   | 40,551         | 39,991         | 36,145         | 31,299         |
| 7                                       | Banesat Sociale + Enti                                      | -              | -              | -              | -              |
| <b>VII</b>                              | <b>Te ardhura nga MZSH</b>                                  | <b>344</b>     | <b>355</b>     | <b>365</b>     | <b>376</b>     |
| <b>VIII</b>                             | <b>Te ardhura te pritshme nga bashkefinancimet e huaja</b>  |                |                |                |                |
| <b>IX</b>                               | <b>Grante te huaja pa planifikuar</b>                       |                |                |                |                |
| <b>X</b>                                | <b>Te ardhura nga shitje mallra ( skrap)</b>                |                |                |                |                |
| <b>TOTAL</b>                            |                                                             | <b>637,975</b> | <b>646,481</b> | <b>651,975</b> | <b>656,747</b> |
| <b>TOTAL + Grantin e pa planifikuar</b> |                                                             | <b>637,975</b> | <b>646,481</b> | <b>651,975</b> | <b>656,747</b> |



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK**

Në përfundim, parashikimi i tavanëve përgatitore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, që do të shërbejnë për procesin e planifikimit të shpenzimeve, është si më poshtë:

Tavanet e të Ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026 – 2028

në mijë lekë

| Lloji i të Ardhurave |                                                       | 2025             | 2026             | 2027             | 2028             |
|----------------------|-------------------------------------------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
|                      |                                                       | Plani            | Plani            | Plani            | Plani            |
| <b>A</b>             | <b>Të Ardhura nga Burimet e Veta</b>                  | <b>637,974</b>   | <b>646,481</b>   | <b>651,975</b>   | <b>656,747</b>   |
| A.1                  | Të Ardhura nga Taksat dhe Tarifat Vendore             | 582,202          | 589,035          | 592,805          | 595,803          |
| A.2                  | Të Ardhurat nga Taksat e Ndara                        | 55,772           | 57,446           | 59,170           | 60,944           |
| <b>B</b>             | <b>Transferta nga Buxheti Qendror</b>                 | <b>907,295</b>   | <b>948,296</b>   | <b>987,217</b>   | <b>1,015,341</b> |
| B.1                  | Transferta e Pakushtëzuar e Pergjithshme              | 476,759          | 517,760          | 556,680          | 584,804          |
| B.2                  | Transferta Sektoriale për rritjen e nivelit të pagave | 68,465           | 68,465           | 68,465           | 68,465           |
| B.3                  | Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale                  | 362,071          | 362,071          | 362,071          | 362,071          |
|                      | <b>Total të ardhura/burime buxhetore (A+B)</b>        | <b>1,545,269</b> | <b>1,594,777</b> | <b>1,639,192</b> | <b>1,672,088</b> |

**TAVANET PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028**

në mijë lekë

| Kodi          | Emërtimi i Programeve                                                            | 2026             |                   |                | 2027             |                   |                | 2028             |                   |                |
|---------------|----------------------------------------------------------------------------------|------------------|-------------------|----------------|------------------|-------------------|----------------|------------------|-------------------|----------------|
|               |                                                                                  | Totali           | Shpenzime Korente | Kapitale       | Totali           | Shpenzime Korente | Kapitale       | Totali           | Shpenzime Korente | Kapitale       |
| AA102         | Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse                                                | 182,043          | 179,224           | 2,819          | 185,249          | 183,249           | 2,000          | 192,000          | 187,000           | 5,000          |
| AB102         | Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile                           | 546,877          | 412,944           | 133,933        | 663,081          | 422,865           | 240,216        | 665,955          | 439,700           | 226,255        |
| AC102         | Arsimi & Kujdesi Social                                                          | 565,425          | 468,995           | 96,430         | 485,745          | 472,745           | 13,000         | 502,000          | 489,000           | 13,000         |
| AD102         | Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërave, Shërbimi Veterinar & Siguria Ushqimore | 60,868           | 57,868            | 3,000          | 59,536           | 58,536            | 1,000          | 60,433           | 59,433            | 1,000          |
| AE102         | Siguria dhe Mbrojtja e Territorit                                                | 92,398           | 91,398            | 1,000          | 94,260           | 93,260            | 1,000          | 96,250           | 95,250            | 1,000          |
| AF102         | Turizmi, Kultura dhe Sportet                                                     | 133,166          | 131,666           | 1,500          | 135,321          | 0                 | 135,321        | 137,450          | 0                 | 137,450        |
| AG102         | Rezerva & Kontigjenca                                                            | 14,000           | 14,000            | 0              | 16,000           | 16,000            | 0              | 18,000           | 18,000            | 0              |
| <b>Totali</b> |                                                                                  | <b>1,594,777</b> | <b>1,356,095</b>  | <b>238,682</b> | <b>1,639,192</b> | <b>1,246,655</b>  | <b>392,537</b> | <b>1,672,088</b> | <b>1,288,383</b>  | <b>383,705</b> |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK

Drafti i parë i PBA 2026-2028 do të paraqitet për miratim nga Këshilli Bashkiak brenda muajit Qershor 2025.

Ju faleminderit !

GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK

|                   |          |                                                                    |
|-------------------|----------|--------------------------------------------------------------------|
| Ervin             | CECA     | Kryetar i Bashkisë ( NA )                                          |
| Arisa             | TOSKA    | Sekretar i Përgjithshëm ( Koordinator )                            |
| Rovena            | SHEHU    | Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave ( Sekretar i GMS ) |
| Etleva            | DHIMA    | N/Kryetar i Bashkisë                                               |
| Bledar            | ÇILI     | N/Kryetar i Bashkisë                                               |
| Arjana            | MARINI   | Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit                |
| Marius            | QYTYKU   | Drejtor i Integritetit Europian dhe Projekteve                     |
| Petro             | SINJARI  | Drejtor i Drejtorisë Juridike                                      |
| Daniel            | BENISHTA | Drejtor i Taksave dhe Tarifave                                     |
| Sokol             | TOSKA    | Drejtor i Shërbimeve, Emergjencave civile, Transportit dhe         |
| Pronave           |          |                                                                    |
| Piro              | XHEBLATI | Drejtor i Shërbimit Social                                         |
| Kreshnik          | ZAIMI    | Drejtor i Policisë Bashkiake                                       |
| Joana             | METAJ    | R/ Drejtor i IMT-së                                                |
| Artan             | MERKO    | Drejtor i MZSH-së                                                  |
| Klodiana          | HOXHA    | Drejtor i Nj. Sh. Drejtoria Arsimore                               |
| Jonana            | MELËNGU  | Drejtor i Nj. Sh. Agjencia e Shërbimeve Publike                    |
| Bledar            | ÇILI     | Drejtor i Nj. Sh. Drejtoria e Bujqësisë, administrim pyje, ujëra e |
| shërbim veterinar |          |                                                                    |
| Arben             | QAFA     | Drejtor i Nj. Sh. Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"            |
| Alma              | KULE     | Drejtor i Nj. Sh. Qendra "Lira"                                    |

**RREGULLORE  
PER  
PERBERJEN, DETYRAT, PERGJEGJESITE  
DHE MENYRËN E FUNKSIONIMIT TE  
KËSHILLIT VENDOR PER SIGURINE  
PUBLIKE NE  
BASHKINE BERAT**

## KREU I

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

#### Neni 1

##### Objekti

Objekti i kesaj Rregullore eshte percaktimi i perberjes, detyrave, pergjegjesive e menyren e funksionimit te Keshillit Vendor per Sigurine Publike ngritur prane Bashkise Berat. Ky është një organ koordinues, identifikues dhe konsultues për çështje të rendit dhe sigurisë, që në bashkëpunim me policinë dhe institucione të tjera sigurie shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë, në të mirë të komunitetit të Bashkisë Berat .

#### Neni 2

##### Baza ligjore

Aktet ligjore kombetare jane:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 29/1;

Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, nenet 1 1/3 pika d dhe 78/2 dhe aktet nenligjore të dala për zbatim të tij.

VKM-nr.678 datë 30.10.2024 “Për përbërjen , rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet”

Aktet nderkombetare jane:

Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut;

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e amenduar;

#### Neni 3

##### Perberja

Keshilli Vendor per Siguri Publike perbehet nga anetaret e meposhtem :

1. Kryetar i Bashkisë Berat
2. Shefi i Komisiariatit të Policisë Berat
3. Drejtuesi Policisë Bashkiake
4. Përgjegjësi drejtorisë rajonale të arsimit parauniversitar

5. Drejtuesi i Emergjencave Civile në Bashkinë Berat
6. Përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
7. Përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
8. Përfaqësuesi i njësisë vendore të kujdesit shëndetësor;
9. Përfaqësuesi i Agjencisë Rajonale të Mjedisit;
10. Përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
11. Përfaqësuesi i administratës rajonale të zonave të mbrojtura;
12. Koordinator i vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;
13. Përfaqësuesi i njësisë për mbrojtjen e fëmijëve;
14. Kryeinspektori/Inspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit;
15. Përfaqësuesi i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit.

#### **Neni 4**

##### **Detyrat e Kryetarit të Këshillit**

1. Kryetari i Bashkisë është kryesuesi i KVSP-se.
2. Kryesuesi i KVSP-se ka përgjegjësi:
  - a) Ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike;
  - b) Organizon mbledhjet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, minimalisht 1 (një) herë në 3 (tre) muaj ose sa herë vlerësohet e nevojshme nga anëtarët e tij;
  - c) Propozon për vendimmarrje në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike detyra dhe masa konkrete, sipas përgjegjësive institucionale për zbatimin e prioritetëve për çështjet e rendit dhe të sigurisë në komunitet;
  - ç) Harton, konsulton, miraton, ndjek dhe raporton planin vjetor të punës, sipas masave të planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet;
  - d) Përfaqëson Këshillin Vendor të Sigurisë Publike në marrëdhëniet me të tretët, duke përfshirë bashkëpunimet me organizmat ndërkombëtarë dhe ata vendas;
  - dh) Fton në mbledhjet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike përfaqësuesit e institucioneve, sipas pikës 4, të këtij vendimi;
  - e) Zhvillon forume të hapura konsultative me qytetarët për identifikimin dhe evidentimin e problematikave, lidhur me sigurinë në komunitet.
3. Mbledhjet e KVSP-se janë të hapura.

4. Kryesuesi i KVSP-se mund të ftojë në mbledhjet e tij përfaqësues nga:

- a) Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- b) Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm;
- c) Komunitetet fetare;
- ç) Organizatat e shoqërisë civile (organizatat rinore, të grave, të bizneseve, të pakicave kombëtare, të universiteteve, të mediave lokale), të komunitetit, sipas rastit;
- d) Këshilli Vendor i Rinisë;
- dh) Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit;
- e) Shoqatat e njësive të vetëqeverisjes vendore;
- ë) Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;
- f) Shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve.

5. Njoftimi për datën e zhvillimit të mbledhjes dërgohet me shkresë zyrtare, të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së përcaktuar, për përfaqësuesit e përmendur në pikën 4, të këtij neni.

## Neni 5

### Detyrat dhe përgjegjësit e KVSP

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike ushtron këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Angazhohet për parandalimin, minimizimin e rreziqeve dhe kërcënimeve në çështjet që cenojnë sigurinë në komunitet;
- b) Mbikëqyr dhe zbaton planin vjetor të punës, sipas masave të planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet;
- c) Identifikon, analizon dhe vlerëson problematikat lidhur me sigurinë në komunitet dhe i trajton ato në mbledhjet e këshillit;
- ç) Propozon zgjidhje për problematikat e rasteve konkrete tek autoritetet kompetente shtetërore, pjesëmarrëse ose jo në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike;
- d) Identifikon prioritetet në fushën e sigurisë në komunitet dhe rekomandon përfshirjen e tyre në mbledhjen e radhës;
- dh) Propozon dhe vlerëson detajet e veprimtarisë së institucioneve përgjegjësie për sigurinë publike në komunitet dhe ia komunikon ato drejtuesve të tyre;
- e) Kontribuon dhe siguron pjesëmarrje në aktivitete ndërgjegjësuere për komunitetin edhe përmes projekteve për çështjet e sigurisë në komunitet;
- ë) Vendosi me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij;

- 6
- f) Merr në shqyrtim përmbushjen e rekomandimeve për çështjet e trajtuara në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike;
  - g) Përcakton përbërjen e sekretariatit teknik.

## **Neni 6**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretariatit Teknik të KVSP**

Sekretariati teknik ushtron këto detyra:

- a) Përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së këshillit vendor nga ana logjistike dhe administrative;
- b) Mban, ruan dhe përditëson të gjitha kontaktet e anëtarëve të këshillit;
- c) Organizon dhe bën koordinimin e mbledhjeve të këshillit;
- ç) Njofton anëtarët për mbledhjen e radhës;
- d) Përgatit materialet përkatëse paraprake të mbledhjes, sipas rendit të ditës për anëtarët;
- dh) Merr pjesë në mbledhjet e këshillit, duke mbajtur minutat e takimit;
- e) Shkëmben informacionin dhe materialet e mbledhjes midis anëtarëve;
- ë) Harton procesverbalet e mbledhjes dhe raportet;
- f) Mban listën e pjesëmarrësve të pranishëm në mbledhje;
- g) Protokollon dhe mban arkivin e procesverbaleve të mbledhjeve;
- gj) Kontrollon adresën elektronike, si mjet të komunikimit elektronik të këshillit;
- h) Përgatit dhe bën publikimin e njoftimeve apo materialeve të ndryshme për publikun

## **Neni 7**

### **Rregullat e mbledhjes së KVSP**

1. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike zhvillon mbledhjet, në bazë të rendit të ditës, të miratuar nga kryetari dhe anëtarët, sipas procedurës së mëposhtme:
  - a) Njoftimi për datën e zhvillimit të mbledhjes dërgohet të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së përcaktuar, me shkresë zyrtare ose në formë elektronike, për të cilën anëtarët kanë rënë dakord;
  - b) Anëtarët njoftohen paraprakisht edhe për rendin e ditës dhe për çdo informacion tjetër të nevojshëm;
  - c) Në përcaktimin e çështjeve të rendit të ditës mund të kontribuojnë edhe anëtarët;
  - ç) Propozime për rendin e ditës mund të dërgohen edhe përmes adresës elektronike nga çdo qytetar;

d) Mbledhjet mbahen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të përhershëm të këshillit. Në rastet kur ky numër nuk plotësohet, mbledhja shtyhet në një datë tjetër, por jo më vonë se 3 (tri) ditë pune;

dh) Në mbledhjet me anëtarësi më të vogël pjesëmarrësish mund të diskutohen çështje, por nuk mund të merren vendime pa kuorumin e nevojshëm;

e) Mbledhja hapet dhe drejtohet nga kryetari, i cili bën edhe prezantimin e rendit të ditës, si dhe një përmbledhje të zhvillimeve të fundit të punës së këshillit;

ë) Kryetari drejton diskutimin, përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës;

f) Anëtarët diskutojnë në bazë të rendit të ditës dhe raportojnë për detyrat;

g) Në mbledhje shqyrtohen me hollësi të gjitha problemet dhe çështjet e parashtruara, sipas rendit të ditës, por anëtarët kanë të drejtën e propozimit për të diskutuar edhe çështje të tjera;

gj) Në përfundim të mbledhjes, mbahet procesverbal nga sekretariati teknik, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët dhe kryetari;

h) Në procesverbal mbahet shënim lista e pjesëmarrësve në mbledhje, si dhe emrat e anëtarëve që nuk kanë marrë pjesë, të cilët duhet të njoftojnë me shkrim arsyet e mospjesëmarrjes;

i) Këshilli vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij;

j) Pas çdo mbledhje, publiku informohet përmes një njoftimi në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse për datën e mbledhjes, pjesëmarrjen, çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës dhe përmbledhjen e diskutimeve;

k) Publikimi i njoftimit bëhet brenda 3 (tri) ditëve pune nga zhvillimi i mbledhjes.

2. Vendimet e marra në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike dërgohen pranë prefektit të qarkut, brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja e tyre.

3. Prefekti i qarkut, pas çdo vendimi të marrë nga Këshilli Vendor i Sigurisë Publike, informon Këshillin Kombëtar të Sigurisë në Komunitet.

### **Neni 8 Gjuhet e përdorura**

1. Mbledhjet e Këshillit mbahen në gjuhën shqipe, duke siguruar përkthimin e pershtatshëm, sipas nevojës edhe në gjuhët e komuniteteve të tjera.

### **Neni 9 Dispozitat kalimtare**

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në kete Rregullore do të behen sipas procedurës se

nxjerrjes se saj.

Kjo Rregullore hyn ne fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Bashkiak Berat.

Rregullorja perbehet nga 7 faqe dhe 9 nene.

**KRYETAR I BASHKISE**

**Ervin Ceca**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
KRYETARI

RELACION

**“ PËR MIRATIMIN E KRIJIMIT TË KËSHILLIT VENDOR PËR SIGURINË  
PUBLIKE NË BASHKINË BERAT”**

Bashkia si njesia baze e vetëqeverisjes vendore, ka si pjese te funksionit te saj, garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve, parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

Per rrjedhoje, ne funksion te ligjit Nr. 139/2015” Per Veteqeverisjen Vendore” neni 29 , si dhe ne zbatim te VKM-nr 678 datë 30.10.2024 “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet”, ne institucionin e Bashkise Berat, do te ngrihet Keshilli Vendor i Sigurise Publike si nje organ koordinues, identifikues dhe konsultues per çeshtje te rendit dhe sigurise, qe ne bashkepunim me Policine dhe institucione te tjera sigurie, do te shqyrtoje te gjitha ceshtjet e sigurise, ne te mire te Bashkise Berat.

Me vendimin nr. \_\_ - date \_\_\_\_\_te Kryetarit te Bashkise, eshte ngritur Keshilli Vendor i Sigurise Publike, i cili do te kryesohet nga Kryetari Bashkise.

Keshilli Vendor i Sigurise Publike , do te organizohet , funksionojë dhe do te zhvillojë mbledhjet , sipas rregullores se miratuar nga Kryetari i Bashkise per kete qellim .

SEKRETARE E PERGJITHSHME  
Arisa TOSKA